

**AKT THEMELIMI**

**ISHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**" QUALITY BUS SERVICE " SHPK "**

Sot me date 18 JANAR 2024 (dymijeenjzetekater) Ortaket Themelues :

**1-Agim Mehmeti** , atesia Skender, i datelindjes 24.06.1976, lindur ne Dures , dhe banues ne Tirane , Njesia Administrative Nr 2, Rruga " Stavri Vinjau ", Pallati Abau Buolding, Shkalla 1, Hyrja 18 , Karte Identiteti me numer personal H60624133S , Shtetas Shqiptar, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar,

**2-Maksut Loçka** , atesia Mersin , i datelindjes 15.08.1963 , lindur ne Yrshek dhe banues ne Yrshek, Komuna Kashar ,Rruga Locka,, Banesa nr 31, Karte identiteti me numer personal G30815126P ,madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar ,

te cilet me cilesine e ortakeve themelues, redaktuan kete Akt Themelimi, mbeshtetur ne Kushtetuten e Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare .ne ligjin 9723, date 03.05.2007, Per Qendren Kombetare te Biznesit, ne kodin doganor, fiskal, tatimor, krijojne Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar " QUALITY BUS SERVICE " shpk

**Neni 1**

**Krijimi**

Sot me daten 18.01.2024 , themeluesit ,krijojne nje Shoqeri me Përgjegjësi të Kufizuar , te quajtur "**QUALITY BUS SERVICE** " , eshte Person Juridik i te Drejtes Shqiptare, Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (ketu e me poshte e quajtur "Shoqeria"). Shoqëria do të ushtrojë funksionet e saj bazuar në këtë Akt Themelimi dhe në Statutin e Shoqërisë që miratohet nga ortaket themelues.

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton Personalitetin Juridik pasi te jete regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.  
Shoqeria, pasi te kete fituar Personalitetin Juridik, eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.  
Secili ortak, gezon kuoten e tij ne shoqeri ne perpjestim me kontributin qe ka dhene ne kapital.  
Shoqeria "**QUALITY BUS SERVICE**" shpk, eshte nje e tille, kapitali i se ciles ndahet ne

Maksut Loçka  


AGIM MEHMETI  


kuota dhe qe themelohet nga ortakët, qe perballon humbjen vetem ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin themeltar.

### **Neni 3 Selia**

Shoqeria e ka seline ne Adresen:

1.Njesia Administrative nr 8, Rruga " Mine Peza ", Pallati 102, Shkalla 1, Apartamenti 18, Tirane.

2.Nr. kontakti per shoqerine eshte: 0692036462

3.Adresa email e shoqerise eshte: agimmehmeti76@gmail.com

Shoqëria mund ta ndryshojë adresën e selisë së saj, të hapë zyra përfaqësie, të hapë degë, apo të krijojë filial si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.

### **Neni 4 Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

### **Neni 5 Objekti I veprimtarise**

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem :

- 1- **Sherbime transporti brenda dhe jashte vendit. Transport Nderkombetar dhe Kombetar pasagjeresh .Udhetime turistike me autobus.**

### **Neni 6 Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete i perbere nga kontibuti ne para i ortakeve themelues te kesaj shoqerie ne leke. Kontributi ne para do te jete i perbere nga shuma prej **1000 (nje mije )** leke, i ndare ne **2 (dy )** kuota. Ortaket themelues te Shoqerise I zoterrojne kuotat ne Shoqeri si me poshte :

*Makrut Loçka*  
*Mus*

**AGIM MEHMETI**  
*Agim Mehmeti*

Z. **Agim Mehmeti** - zoterues i 1 (nje) kuote qe perfaqeson 51% te kapitalit te shoqerise ne vlere nominale 510 (peseqindedhjete ) leke

Z. **Maksut Loçka** - zoterues i 1 (nje) kuote qe perfaqeson 49% te kapitalit te shoqerise ne vlere nominale 490 (katerqindenentedhjete ) leke

Kapitali themeltar i Shoqerise perfaqeson kapitalin e derdhur nga ortaket themelues. Depozitimi i kapitalit te shoqerise do te behet, pas rregjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit. Ne librin e llogarive qe do te krijohet ne Shoqerine Tregtare do te shenohet dhe kapitali i derdhur nga ortaket e shoqerise. Rritja e kapitalit nga ortaket nuk eshte i kufizuar.

### **Neni 7** **Transferimi I kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar e te drejttat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet

- a- kontibutit ne kapitalin e shoqerise
- b- shitblerjes
- c- trashegimise
- d- dhurimit
- e- cdo menyre tjeter e parashikuar ne ligj

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim. Ky Statut kushtezon kalimin e kuotave te treteve jasht shoqerise, me miratimin e Shoqerise dhe te drejften e parablerjes ne favor te Shoqerise, apo te ortakeve te tjere, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi qe e kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate, pergjigjen ne menyre solidare ndaj Shoqerise, per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga casti i kalimit te kuotave, deri ne castin e rregjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit. Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve  
Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie

### **Neni 8** **Organi vendimarrës**

Asambleja e Ortakeve eshte Organi i vetem vendimarrës i Shoqerise

*Maksut Loçka*  
*Mues*

AGIM MEHMETI  
*[Signature]*

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarrës i Shoqerise qe miraton cdo ndryshim te Statutit sipas modaliteteteve te percaktuara ne ligj.  
Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per Shoqerine per ceshtjet e meposhtme

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
- Ndryshimet e Sstatutit
- Emerimin dhe shkarkimin e Admimistratoreve
- Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- Mbikqyrjen dhe zbatimin e politikave tregtare nga administratorët,perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- Perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- Riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise
- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te Asamblese
- Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i tretë.

Administratori i Shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne Asamblene e Pergjithshme,  
Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme ,e cila perfshin dhe mbledhjet vijuese per te njejtin rend dite.

**Mbledhjet e Ortakeve te Shoqerise , behen edhe online. Ne kete rast dokumentaçioni per vendimmarrjet percillet nepermjet emailt , te firmosura dhe te skanuara ne pdf.**

## **Neni 9 Administrimi**

Shoqeria do te administrohet nga 1 ( nje ) Administrator  
Administrator i Shoqerise eshte Z –**Agim Mehmeti** , atesia Skender lindur ne Durres dhe banues ne Tirane ,me numer personal H60624133S

Kohezgjatja e mandatit te Administratorit do te jete 5-vjecar, me te drejte ripertesitje vetem ne rastet kur jep doreheqjen.

Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje Administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund ta perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

Pervec kesaj, Administratori shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjit, me kerkese te cdonjerit prej ortakeve.Tagrat e perfaqesimit te Administratorit dhe cdo ndryshim i tyre njoftohen per rregjistrim prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Emertimi I Administratorit prodhon efekte pas regjistrimit te tij ne QKB.

*Maksut Doka*  
*Mues*

AGIM MEHMETI  
*Agim Mehmeti*

## Neni 10 Kopetencat e administratorit

Administrator ka te drejte dhe detyrohet te :

- kryeje te gjithe veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te Shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e pergjithshme e ortakeve.
- perfaqesoje Shoqerine tregtare
- kujdeset per mbajtjen sakte e te rregullt te dokumenteve e te librave kontabel te Shoqerise.
- pregatise dhe te nenshkruasj bilancin vjetor dhe raportin e ecurise se shoqerise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumenta perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per miratim.
- te krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise
- kryen regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te Shoqerise, sic parashikohen ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit

Administratori e perfaqeson Shoqerine perpara te gjithe Personave Fzike dhe Juridik, Publik apo Privat, Vendas apo te Huaj, Autoritetve Shtetore Shqiptare apo te Huaja, si dhe Autoriteteve Gjyqesore te te gjitha shkalleve.

Administratori ka te gjitha kopetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet, ne emer te Shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te rasteve ku ligji ia jep kopetencet Ortakeve te Shoqerise

Administratori angazhon Shoqerine ne marredhenie me te tretet, nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

## Neni 11 Viti financiar

Viti financiar I shoqerise fillon me 01 janar dhe perfundon me 31 dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te Shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me date 31 dhjetor

## Neni 12

### Prishja dhe likuidimi

Shperndarja dhe prishja e Shoqerise mund te behet ne cdo kohe

- Kur mbaron kohezgjatja e percaktuar ne themelimin e saj
- Me vendim te Asamblese se Pergjithshme
- Me hapjen e procedurave te falimentit
- Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i

*Maxsut Lopez*  
*[Signature]*

*AGIM MEHMETI*  
*[Signature]*

veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr 9723 date 03.05.2007 per  
QKB  
Me vendim te gjykates

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likujdimit te Shoqerise , duke caktuar 1 (nje ) apo disa likujdatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij Emrin e Likujdatorit dhe emertesenshtese “ Shoqeri ne likujdim e siper”

### **Neni 13 Baza ligjore**

Shoqeria do e zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe dispozitat e legjistacionit shqiptar

Per sa nuk parashikohet ne kete Statut do te zbatohen dispozitat e ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise

### **Neni 14 Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij Statuti, si dhe cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kopetente Gjykata Shqiptare

### **Dispozita perfundimtare**

Ky Akt Themelimi hartohet ne tre kopje identike, pasi u redaktua dhe lexua nga ortakët themelues, miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket Themelues te Shoqerise Tregtare “” **QUALITY BUS SERVICE** ” shpk, nen shkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre origjinale.

### **ORTAKET**

Maksut Loçka  
Mues

AGIM MEHMEI,  
Hilaf